



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Diskutimi në parim i shpenzimeve të projektbuxhetit të vitit 2019.
3. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj dhe Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Reme Lala, dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë për Buxhetin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Fran Ibrahim – Drejtor i Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtoreshë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në rendin e ditës së sotme të punës së këtij komisioni kemi dy çështje:

1. Diskutimi në parim i shpenzimeve të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2019.

2. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar””.

Për pikën e parë të rendit të ditës, për prezantimin e shpenzimeve të parashikuara në projektbuxhetin 2019 ndodhet sot në komision zoti Arben Ahmetaj, ministër i Financave dhe Ekonomisë.

Relator i komisionit për këtë projektligj është zoti Anastas Angjeli.

Do të procedojmë me prezantimin e shpenzimeve të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2019 nga zoti ministër dhe më tej, do të flasë relatori i komisionit.

Më pas do të vijojmë me pyetje dhe diskutime.

Fjalën e ka zoti ministër!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Në vazhden e diskutimeve që kemi së bashku në parim dhe më pas nen për nen, sot do të bëjmë prezantimin e shpenzimeve të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2019. Shpenzimet buxhetore për vitin 2019 do të vijojnë të mbështesin sektorët prioritarë, si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, bujqësia, të cilat do të stimulojnë më tej rritjen ekonomike të vendit duke gjeneruar njëkohësisht punësim.

Për vitin 2019, shpenzimet buxhetore do të kapin për herë të parë vlerën absolute prej 519,4 miliardë lekësh ose 29,6% të PBB-së. Krahasuar me të pritshmin e vitit 2018, totali i shpenzimeve buxhetore programohet me rreth 5,9% më shumë. Në terma realë, kuptohet se shpenzimet buxhetore do të pësojnë një rënie të lehtë, e cila vjen si pasojë e përmbushjes së objektivit madhor kombëtar të konsolidimit fiskal.

Shpenzimet e personelit në vitin 2019 planifikohen në nivelin 80,6 miliardë lekë. Në terma realë, shpenzimet e personelit vijojnë të mbajnë një trend konstant me 4,6% krahasuar me tre vjetët e fundit, gjë që dëshmon politikën shumë të kujdesshme të qeverisë në mbajtjen nën kontroll të këtyre shpenzimeve. Kjo politikë e kujdesshme reflektohet edhe në numrin total të punonjësve buxhetorë, që propozohen si limit në këtë projektbuxhet dhe vazhdon të

qëndrojnë në shifrën prej 82 mijë e 22 punonjës buxhetorë, ashtu sikurse janë planifikuar që prej vitit 2016, si vit i parë i delegimit të disa funksioneve në njësitë e qeverisjes vendore.

Nga politika e rritjes së pagave do të përfitojnë sipas sektorëve kategoritë e mëposhtme:

Sektori i shëndetësisë:

Është parashikuar një rritje page prej mesatarisht 7% për 4 650 mjekë;

Rritje page mesatarisht 7% për ndihmësmjekët. Do të përfitojnë nga kjo politikë 13 765 infermierë, laborantë dhe farmacistë.

Efekti financiar vjetor për këto kategori përlllogaritet në rreth 1 miliardë lekë.

Sektori i arsimit:

Është parashikuar një rritje page mesatare 7% për 35 873 punonjës, staf mësimor të arsimit parauniversitar. Efekti për këtë kategori do të jetë 1,37 miliardë lekë.

Sektori i mbrojtjes:

Do të përfitojnë 6800 ushtarakë aktivë. Kuadri i rritjes për pagat e ulëta do të jetë rreth 15-19 %, por rritja do të variojë midis 10 dhe 19 %.

Sistemi penitenciar do të ketë rritje të pagës mesatarisht me 7% nga e cila do të përfitojnë rreth 3559 policë të burgjeve. Efekti financiar vjetor për këtë kategori përlllogaritet rreth 177,2 milionë lekë.

Mbështetje për diplomatët:

Është parashikuar rritje page mesatarisht 20% nga e cila përfitojnë rreth 308 punonjës të përfaqësive diplomatike. Efekti financiar vjetor për këtë kategori përlllogaritet rreth 120 milionë lekë.

Krahas kësaj, në këto shpenzime planifikohet kostoja dhe financimi i reformës në drejtësi, për akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë, si dhe akomodimi i institucioneve të reja të krijuara për mbështetjen e kësaj reforme, qoftë Byroja Kombëtare e Hetimit, qoftë SPAK-u.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes do të kapin vlerën 48,6 miliardë lekë, duke prioritarizuar skemat produktive dhe mirëmbajtjen e aseteve të rëndësishme publike, si mbështetja e skemës së fermerëve me 2,6 miliardë lekë, e cila vijon të mbajë të njëjtin nivel sikurse në vitin 2018, por që në diferencë nga ky vit do të ketë dhe një komplementim nga fillimi i zbatimit të skemës së IPARD-it, ku koncepti është financimi nga qeveria nëpërmjet buxhetit në masën 25% dhe IPARD-i pjesën e mbetur, që do të thotë se duke alokuar 1 miliard lekë në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë, kjo ministri i ka të gjitha mundësitë të tërheqë 3 miliardë lekë nga IPARD-i, duke e çuar investimin në skema në vlerën 40 milionë

dollarë IPARD-i, plus 26 milionë dollarë nga buxheti. Pra, mbështetja për fermerët. vetëm nga këto dy skema investimi në bujqësi, shkon 66 milionë dollarë, pra 6,6 miliardë lekë që vetëm në këtë aspekt dhe në këtë korsi, është rekord.

Mirëmbajtja e rrjetit kombëtar të rrugëve me një kombinim midis buxhetit, pra burimeve të brendshme, tek operativet 1,7 miliardë lekë, e cila së bashku me projektin e Bankës Botërore për mirëmbajtjen e rrugëve, do të ofrojë si asnjëherë më parë më shumë financim për mirëmbajtjen e domosdoshme dhe cilësore të rrugëve nacionale, që do të kalojë në nivele gati 4,2 miliardë lekë.

Mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit në administratën publike qendrore me vlerë rreth 1,7 miliardë lekë.

Siç e keni parë, dixhitalizimi ka qenë një nga prioritetet për t'u mbështetur. Sigurisht, investimet në teknologjinë e informacionit shoqërohen domosdoshmërisht me mirëmbajtje. Kjo është dhe arsyeja se përse kjo shifër është kaq e konsiderueshme. Vlen të përmendet dhe nisma e qeverisë shqiptare për të qendëruar shpenzimet e mirëmbajtjes së të gjitha sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin 41,7 miliardë lekë ose 2,4% të PBB-së, për të përballuar një rritje të mundshme të normave të interesit nga 1 pikë përqindje apo 2 pikë përqindje. Vlen të theksohet këtu se fatura e shpenzimeve për interesat e kredive të marra, e cila pa kontingjencën e parashikuar për luhatjen e normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, shkon në vetëm 2,1% dhe ka ardhur dukshëm në rënie krahasuar me fundin e vitit 2013, kur ishte 3,2%, gjë që tregon dhe një herë tjetër vendosmërinë e kësaj qeverie për uljen e borxhit publik dhe për pasojë, uljen e kostos së shërbimit të borxhit.

Subvencionet parashikohen me ulje në terma absolutë dhe relativë, krahasuar me një vit më parë, ku planifikohen rreth 1,5 miliardë lekë ose 0,1% të PBB-së. Kjo ulje vjen si pasojë e rialokimit të një pjese të mirë të subvencionit të parashikuar për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizime tek investimet publike në rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve, në kuadër të përsheptimit të reformës së ndërmarrë për këtë sektor jetik.

Për sa u takon zërave të tjerë me peshë, kemi subvencionet për nxitjen e punësimit, që qëndrojnë konstante krahasuar me vitin 2018 (490 milionë lekë), të cilat vijnë të përdoren në funksion të punësimit të qëndrueshëm të punëkërkuësve të papunë, duke qenë në sinkron të plotë me skemat e tjera të aftësimin dhe të formimit profesional;

Subvencionet për sistemin hekurudhor mbeten në të njëjtin nivel, sikurse edhe në vitin 2018 me 400 milionë lekë, por në ndryshim nga vjet, ka një lajm të mirë për këtë sektor,

pasi në vitin 2019 do të startojë projekti i financuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bashkimi European dhe qeveria shqiptare me një vlerë totale 90,5 milionë euro për rehabilitimin e linjës hekurudhore Tiranë – Durrës, si dhe për ndërtimin e linjës së re hekurudhore Tiranë – Rinas, e cila pritet që të përfundojë brenda vitit 2020. Ky projekt, përveç rritjes së transportit të mallrave dhe personave nëpërmjet këtyre linjave për shkak të kostove më të lira, që ofron ky lloj transporti, do të vendosë në kushte më të favorshme nga pikëpamja financiare këtë sektor, i cili prej vitesh ka vuajtur mungesën e vëmendjes dhe të investimeve të qenësishme.

Shpenzimet e fondeve speciale, që përfshijnë shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën 179,98 miliardë lekë për vitin 2019, ku renditen:

Skema e sigurimeve shoqërore. Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2019 parashikohet në masën 130,63 miliardë lekë ose 7,5% e PBB-së, raport ky i njëjtë me vitin 2018. Nga kjo shumë është parashikuar për indeksimin e pensioneve një fond prej 2,45 miliardë lekësh. Duhet theksuar këtu se krahasuar me vitin 2013, kjo skemë i rëndon më pak buxhetit të shtetit, pasi në vitin 2013 transferta buxhetore zinte rreth 46,2% të totalit të shpenzimeve, ndërkohë që sot zë vetëm 35,6% të totalit të shpenzimeve. Kjo ka ardhur si pasojë e dy faktorëve kryesorë:

- Uljes së informalitetit në tregun e punës;
- Rritjes së nivelit të punësimit dhe të kontribuuesve, ku vlen të përmendim, se numri mesatar i kontribuuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet të jetë me rreth 809 mijë persona, me një rritje në masën 7,3% më shumë se i pritshmi i vitit 2018.

Për skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019 janë parashikuar 41,9 miliardë lekë ose 2,4% të PBB-së nga 40,4 miliardë lekë të parashikuara në vitin 2018.

Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohet në total në masën 5 miliardë lekë ose 0,3% të PBB-së. Krahasuar me vitin 2013, në të cilin fondi ishte 1,89 miliardë lekë dhe, duke filluar nga viti 2016 fondi i kompensimit është planifikuar në rritje nga vit në vit, duke kulmuar në vitin 2021 me 5,5 miliardë lekë. Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga qeveria për trajtimin e ish-pronarëve pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10-vjeçare, të parashikuar dhe në ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit”.

Shpenzime të tjera sociale që përfshijnë shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në 500 milionë lekë, shumë, e cila vjen në ulje krahasuar me planin e vitit 2018,

duke reflektuar kështoj rritjen gjithmonë e më shumë të numrit të të punësuarve dhe nevojën gjithnjë e më të paktë për të aplikuar për këtë skemë sociale. Gjej rastin për të theksuar se prej tre vjetësh garantohet për këtë kategori një pagesë sipas standardeve të ILO-s prej jo më pak se gjysma e pagës minimale;

Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 20,5 miliardë lekë, në të njëjtin nivel si vitin e kaluar, duke reflektuar reformat e ndërmarra të synuara nga qeveria për:

- Zhveshjen e këtyre skemave nga përfitues abuzivë;
- Punësimin dhe riintegrimin social të këtyre kategorive nëpërmjet skemave të ndryshme të aftësimit dhe punësimit.

Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh ose 0,1% e PBB-së, ku sërish mbetet prioritet dëmshpërblimi i plotë dhe sa më i shpejtë i ish- të përndjekurve të gjallë.

Për bonusin e lindjeve, apo siç i referohemi bonusi i bebeve, është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekësh ose 0,1% e PBB-së. Nga kjo politikë e re pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje gjatë vitit 2019.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2019 planifikohet në masën 3 miliardë lekë, përkatësisht 1,5 miliardë lekë është fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 1,5 miliardë lekë është fond kontigjence për financimin e pagave të reja për magistratin dhe ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

Investimet publike për vitin 2019 janë planifikuar në masën 5,1% të PBB-së ose në vlerën 88,8 miliardë lekë (duke përfshirë këtu dhe mbështetjen për sektorin e energjisë me 3 miliardë lekë).

Në planifikimin e investimeve për vitin 2019 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu si në vitin 2018, edhe në vitin 2019 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre brenda vitit të fundit të mandatit të qeverisë.

Për sa i përket mbështetjes së sektorëve prioritarë, dëshiroj ta filloj me arsimin ku, në raport me prodhimin e brendshëm bruto, synojmë të mbajmë një nivel konstant prej 3% gjatë periudhës 2019-2021. Përveç rritjes së parashikuar të pagave për mësuesit në vitin 2019, në këtë sektor do të financohet me përparësi:

ofrimi i teksteve shkollore falas për 190 mijë nxënës të arsimit parauniversitar, nga të cilët 125 mijë janë nxënës të klasave nga e parë në të katërtën, me kosto vjetore 610 - 700 milionë lekë;

transport i siguruar për 28 mijë nxënës me vendbanim mbi dy kilometra larg nga shkolla, si dhe për 10 mijë mësues që punojnë mbi pesë kilometra larg nga vendbanimi apo qendra e përhershme e punës në shkollë me kosto vjetore 650-680 milionë lekë në vit;

trajtimi me kuotë ushqimore për 1000-1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë.

Për arsimin bazë:

ndërtime të reja dhe shtesa objektesh (15-20 objekte shkollore) në vlerën 0,8 miliard lekë (400 milionë në vitin 2019);

rikonstruksione deri në 100 shkolla me 2,5 miliardë lekë (1,25 miliard lekë në vitin 2019);

Për arsimin e mesëm të përgjithshëm:

ndërtime të reja dhe shtesa objektesh (6-10 objekte shkollore) në vlerën 660 milionë lekë (300 milionë lekë vitin 2019);

rikonstruksione në rreth 40 shkolla me vlerë rreth 1,5 miliard lekë (750 milionë lekë për vitin 2019);

Për arsimin e mesëm profesional:

ritje e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2021, krahasuar me 42% në vitin 2018;

ritje e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale nga 3300 nxënës në 2018 në 3600 nxënës në vitin 2021;

ritje e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale, të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 40% e totalit në vitin 2018 në 55% e totalit në vitin 2021;

Për sa i përket shëndetësisë, financimi do të mbetet mesatarisht në nivelet 2,9% për periudhën 2019-2021. Përveç rritjes së pagave për mjekët dhe infermierët do të synohet:

reduktimi në më pak se 15% i numrit të pacientëve të rishtuar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orësh nëpërmjet urgjencës;

reduktimi i kohës së pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner) në më pak se 45 ditë;

reduktimi i indeksit të vdekshmërisë foshnjore për periudhën 2019-2021;

garantimi i mbulesës vaksinale;

rikonstruksioni dhe pajisja me mjetet e nevojshme e 200 qendrave shëndetësore, 100 qendra çdo vit, 80 prej të cilave përfundojnë në vitin 2018.

Për sa i përket skemës së rimbursimit të barnave, kemi konstatuar se kjo skemë ka kërcyer rreth 23,6% më shumë se viti 2016 dhe për këtë arsye ka nevojë për një reformë që

sjell efikasitet dhe efektivitet më të lartë të kësaj skeme. Për këtë qëllim, ne kemi propozuar në nenin 5 që të përcaktohet specifikisht tavan i shpenzimeve për këtë skemë me 10,5 miliardë lekë, për të incentivuar më tej ndërmarrjen e kësaj reforme të domosdoshme.

Bujqësia do të vazhdojë të përfitojë në terma realë 0,6% të prodhimit të brendshëm bruto për periudhën 2019-2021, ku synohet:

rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore që i ofrohet shërbimi i ujitjes nga 65,3% në vitin 2019 në 68,1% të totalit potencial prej 360 mijë hektarë tokë në vitin 2021;

numri i fermerëve të mbështetur nga skemat kombëtare mesatarisht 3600 përfitues në vit me kosto vjetore 2,6 miliardë lekë. Fillimi i skemës së IPARD-it do ta rrisë shumë më tej këtë numër përgjatë viteve 2019-2021;

Rritje e sipërfaqeve të mbjella me dru frutorë nga 36,1 mijë hektarë në vitin 2019 në 38 mijë hektarë në vitin 2021;

rritja e sipërfaqes së mbjellë me perime në sera nga 1750 hektarë në vitin 2019 në 2010 hektarë në vitin 2021. Për dijeninë tuaj, dy sektorët të mirëfinancuar janë bujqësia, siç jua shpjegova më lart, dhe infrastruktura, kjo për shkak të hapjes së një kantieri super të madh në të gjitha rrugët e Shqipërisë.

Infrastruktura, siç e theksova, do të përfitojë fonde të konsiderueshme përgjatë viteve 2019-2021, rreth 2.8 % të prodhimit të brendshëm bruto, ku synohen:

akset rrugore nacionale si: Rruga e Arbrit, Thumanë – Vorë – Kashar, Kashar – Rrogozhinë, Milot – Balldren dhe Orikum – Dukat janë pjesë e projektit 1 miliard për rindërtim brenda vitit 2021;

kompletimi i pjesës dërrmuese të segmenteve rrugore në vazhdim me financim të brendshëm brenda vitit 2021, si: Kardhiq – Delvinë, Elbasan – Banjë, baipasi i Shkodrës, baipasi i Tepelenës dhe një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës;

kompletimi i segmenteve rrugorë brenda 2021 me financim të huaj si: baipasi i Fierit, baipasi i Vlorës, Qukës – Qafë Plloçë dhe në mars të këtij viti bëhet plotësisht e kalueshme edhe rruga Tiranë-Elbasan;

ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 23%.

Fondi i mirëmbajtjes së rrugëve në periudhën 2019-2021 është më i larti i 25 viteve të fundit.

Nxitja e Punësimit, ku synohet:

punësimi në total i 7260 të papunëve nga grupe të veçanta;

përfshirja në programet e nxitjes së punësimit të praktikave profesionale të rreth 2250 të rinjve të sapodiplomuar në arsimin e lartë;

punësimi në total i rreth 900 grave kryefamiljare me fëmijë në ngarkim dhe vajza nëna;

trajnimi nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit të rreth 5100 të papunëve të trajtuar më parë me ndihmë ekonomike.

Shpenzimet për buxhetin vendor për të tretin vit radhazi do të vazhdojnë të mbështesin reformën administrativo-territoriale dhe reformat e decentralizimit. Në projektbuxhetin e vitit 2019 burimet e financimit të qeverisjes vendore do të rriten me 5 miliardë lekë ose 11% më shumë se ato të vitit 2018. Mos harroni që, krahasimisht, rritja e shpenzimeve të qeverisjes qendrore me qeverisjen vendore, qeverisja vendore rritet me ritëm dyfish më të lartë sesa qeveria qendrore. Ndër masat më të rëndësishme në këtë aspekt përmendim miratimin dhe zbatimin rigoroz të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore dhe reformën për taksën e ndërtesave me ngritjen e strukturave të posaçme dhe krijimin e kadastrës fiskale. Të gjitha këto dëshmojnë vullnetin dhe seriozitetin e qeverisë për decentralizim dhe zbatimin e reformës administrative-territoriale.

Shpenzimet për buxhetin vendor për vitin 2019 janë parashikuar në masën 51,14 miliardë lekë, të cilat zënë 2,9% të prodhimit të brendshëm bruto nga 2,3% që zinin në vitin 2013. Pjesa më e madhe, mbi 60% e këtyre shpenzimeve, shkojnë për investime dhe shërbime publike për komunitetet vendore. Burimi kryesor i rritjes së shpenzimeve vendore për vitin 2019 vjen kryesisht nga rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e veta si dhe nga rritja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019 parashikohet të kenë një rritje me mbi 3,8 miliardë lekë më shumë sesa plani i vitit 2018 ose e thënë ndryshe, një rritje prej 21%. Ndërkohë, krahasuar me vitin 2015, të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme rreth 90%. Kjo rritje e nivelit të të ardhurave do të vazhdojë si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmirësimin e vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, reforma që ka filluar në taksën e pronës, konkretisht për taksën mbi ndërtesat dhe ngritjen e kadastrës fiskale, parashikohet të ndikojë ndjeshëm në rritjen e të ardhurave në buxhetin vendor për vitin 2019 dhe për vitet e tjera në vazhdim.

Në buxhetin vendor të vitit 2019, në vijim të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit, vend të rëndësishëm zë reforma e financimit të arsimit parashkollor. Fondet

për pagat e edukatorëve në vitin 2019 do të rriten me 9,1% në krahasim me vitin 2018. Në të njëjtën kohë, do të përmirësohet sistemi i ndarjes së fondeve ndërmjet bashkive.

Nga ndryshimi i skemës së sipërpërmendur, ku fondet ndaheshin sipas numrit të edukatorëve, konform praktikave të mira ndërkombëtare, financimi i këtij funksioni për vitin 2019 do të bazohet kryesisht në numrin e nxënësve (fëmijë 3-6 vjeç), si një kriter më objektiv për përcaktimin e nevojave për shpenzime.

Kështu, 60% e transfertës për arsimin parashkollor do të ndahet bazuar në numrin e fëmijëve 3-6 vjeç dhe 40% do vazhdojë të ndahet mbi numrin e edukatorëve. Nga kjo reformë, në buxhetin e vitit 2019 nuk do ketë asnjë bashki që humbet fonde, përkundrazi, pjesa më e madhe e bashkive do të jenë fituese në fonde për këtë shërbim. Kështu, si rrjedhojë e kësaj reforme, do të punësohen 438 edukatorë më shumë se në vitin 2018, të cilët do të shkojnë në 32 bashki, të cilat kanë një nevojë më të madhe për shtimin e edukatorëve, e matur nga raporti “fëmijë për edukatorë”.

Kjo reformë do ketë ndikim të drejtpërdrejt në uljen e madhësisë mesatare maksimale të grupeve në kopshte nga 26 në 18 nxënës për edukatorë dhe madhësisë mesatare kombëtare nga 18 në 15 nxënës për edukatorë, duke krijuar kështu parakushte për një sistem efikas.

Buxheti vendor i vitit 2019 do të jetë buxheti në të cilin gjen zbatim të plotë gjithashtu ligji për financat e vetëqeverisjes vendore, ku jo vetëm ka fonde më shumë sesa në vitet e mëparshme, por tashmë kemi dhe një kuadër të plotë procedurash, rregullash dhe kriteresh të menaxhimit financiar vendor, çka garanton efektivitet dhe eficiencë në përdorimin e parave publike në nivel vendor.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Ministër për prezantimin!

Në emër të relatorëve, fjalën e ka zonja Evis Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit!

Faleminderit, zoti Ministër për prezantimin tuaj!

Ne diskutuam për shpenzimet e parashikuara të projektbuxhetit edhe në seancën e parë të diskutimit në parim të projektbuxhetit ku prezantuam relacionin e plotë të komisionit.

Prandaj, sot, duke qenë se edhe prezantimi juaj ishte shumë shterues, do të ndalem shkurt vetëm në tri çështje, për të cilat do të ngre edhe tri pyetje, që mendoj se kanë nevojë për një sqarim më të detajuar nga ana juaj.

Së pari, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2019 parashikohen në nivelin 519,4 miliardë lekë ose 29,6% e produktit të brendshëm bruto.

Në krahasim me aktin normativ të buxhetit të vitit 2018, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit parashikohet të rriten me 22,3 miliardë lekë ose 4 pikë përqindje. Kjo rritje do të vazhdojë gjatë gjithë periudhës afatmesme, pra edhe në vitin 2020 dhe vitin 2021, përkatësisht duke parashikuar një rritje të shpenzimeve të përgjithshme prej 29,2 miliardë lekësh ose 5,6% në vitin 2020 dhe 29,7 miliardë lekësh ose 5,4 pikë përqindje për vitin 2021. Megjithatë, vërehet një rënie e ritmit të rritjes së shpenzimeve të përgjithshme nga 7,7% në vitin 2018 në 4,5% në vitin 2019, në 5,6% në vitin 2020 dhe 5,4% për vitin 2021.

Në raport me produktin e brendshëm bruto, shpenzimet e përgjithshme për vitin 2019 përbëjnë 29,6% nga 30,2% e produktit të brendshëm bruto sipas aktit normativ të vitit 2018. Kjo tendencë në rënie e ritmit të këtyre shpenzimeve vijon edhe për periudhën afatmesme, të cilat janë respektivisht 29,3% dhe 28,9% e produktit të brendshëm bruto në vitet 2020 dhe 2021. Atëherë, kjo është pyetja ime e parë për ministrin. Kërkoj nga ministri një informacion më të plotë dhe të detajuar për këtë nivel të parashikuar të shpenzimeve buxhetore.

Për sa u takon investimeve publike, në vitin 2019 parashikohen në nivelin 88,8 miliardë lekë ose 5% e produktit të brendshëm bruto. Këtu përfshihet edhe mbështetja për sektorin e energjisë me 3 miliardë lekë. Në krahasim me aktin normativ të vitit 2018, investimet publike parashikohen të rriten me 2,1 miliardë lekë ose 2 pikë përqindje. Planifikimi i investimeve mbështetet në prioritetet e programit të qeverisë dhe ato të integritit europian, financimin e projekteve në vazhdim, si dhe mbështetjen me kosto lokale e TVSH-së të projekteve me financim të huaj. Në këtë kuadër kërkoj nga ministria një informacion më të detajuar se sa është financimi për projektet në vazhdim dhe sa për projektet e reja. Pra, të bëhet një ndarje e këtyre dy zërave.

Gjithashtu, në raport me produktin e brendshëm bruto, investimet publike kanë një rënie të lehtë nga 5,3% e produktit të brendshëm bruto në aktin normativ të vitit 2018 në 5% të produktit të brendshëm bruto në vitin 2019, në 4,9% në vitin 2020 dhe 4,8% në vitin 2021. Gjithashtu, ritmi i rritjes së investimeve publike ka rënie nga 26,6% në aktin normativ të vitit 2018 në 0,9% në vitin 2019, në 4,8% në vitin 2020 dhe 4,5% në vitin 2021.

Edhe për këtë mendoj se Ministria e Financave duhet të na japë pak më shumë informacion për këtë parashikim të investimeve publike.

Së fundi, projektbuxheti parashikon zhvillimin me prioritetet e sektorëve të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe infrastrukturës. Pra, këta katër sektorë prioritarë mbështeten nga projektbuxheti.

Ndryshimet që sjell projektbuxheti i vitit 2019, në krahasim me vitin 2018, në këto ministri që mbulojnë këta sektorë, janë si më poshtë:

në Ministrinë e Arsimit shpenzimet janë rritur me 1,1 miliardë lekë ose 2,9% e produktit të brendshëm bruto.

në Ministrinë e Shëndetësisë janë rritur me 2,4 miliardë lekë ose 4,1% e produktit të brendshëm bruto.

në Ministrinë e Bujqësisë shpenzimet janë rritur me 0,4 miliardë lekë ose 3,4% e produktit të brendshëm bruto.

Ndërsa, në Ministrinë e Infrastrukturës shpenzimet janë reduktuar me 1,1 miliardë lekë ose 2,2 % e produktit të brendshëm bruto. Mendoj se edhe për këtë reduktim të shpenzimeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duhet një informacion më i plotë duke qenë se është një sektor prioritar.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Kushi!

Po, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Ashtu siç e parashikoi edhe zonja Kushi, praktikisht, niveli i shpenzimeve në raport me prodhimin e brendshëm bruto do të mbahet i kontrolluar në funksion të objektivit madhor që ne kemi, të konsolidimit fiskal.

Tashmë është e njohur, patjetër midis nesh, sepse ju jeni aktorët kryesorë të kontrollit, por edhe të orientimit të financave publike, që niveli i borxhit publik në Shqipëri, megjithëse është ulur nga viti në vit, vazhdon të jetë tejet i lartë dhe risku kryesor i shëndetshmërisë së ekonomisë së Shqipërisë, sidomos të financave publike.

Thënë kjo, detyra jonë është që në kohë si këto, që unë do t'i konsideroja relativisht të strukturuar për financat publike, ne të gjithë, ju si komision dhe ekzekutivi, të punojmë për të vendosur ato që ne i referohemi teknikisht amortizatorët e riskut të financave publike dhe të ekonomisë.

Kjo është arsyeja pse ecim kujdesshëm. Të dyja elementet, borxhi i lartë në njërën anë, që pastaj shoqërohet me riskun e financimit ... Po ta shikoni në tabelën fiskale, në referencë të shifrave në raport me prodhimin e brendshëm bruto dhe po të shikoni planifikimin e interesave, interesat vijnë në planifikim në rritje. Ne kemi referencën e Bankës Qendrore të Shteteve të Bashkuara, *Federal Reserve*, që ka aplikuar tashmë një parashikim dhe e ka bërë hapin e parë të rritjes së interesave. Kini parasysh që 0,5 pikë përqindje rritje na çon në nivele 25 milionë dollarë, gati 3 miliardë lekë kosto të menjëhershme në buxhet. E

rëndësishme është që ka kategori të cilat janë relativisht të ngrira apo të kushtëzuara brenda buxhetit.

Për shembull, transferta e përgjithshme e pakushtëzuar për pushtetin vendor; është me ligj 1%-shi i prodhimit të brendshëm bruto.

Detyrimet ndaj NATO-s vijnë gjithnjë duke u rritur, madje këtë vit shkojnë 1,25% të prodhimit të brendshëm bruto. Mos harroni që deri në vitin 2024 do të duhet të shkojmë deri në 2% të prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që do të duhet të ulim borxhin. Kjo është arsyeja pse ajo që theksuat shumë qartazi se, në raport me prodhimin e brendshëm bruto, shpenzimet shkojnë në ulje. Në të njëjtën kohë investimet publike janë të rëndësishme në të dyja korsitë.

E para, qeveria, si aktor ekonomik, investon konsiderueshëm në raport me mundësitë e saj financiare, pra gjithmonë mbi 5% të prodhimit të brendshëm bruto. Viti i kaluar ka një aspekt, ku energjia prandaj kaloi te 5,3%-shi, që iu referuat ju, sepse energjia e mori hapësirën shumë shpejt dhe kaloi nga 3% në 5%. Pra, me aktin normativ lejuam rritjen e pozicionit neto të energjisë nëpërmjet buxhetit ku reflektohet brenda deficitit buxhetor. Kjo është edhe arsyeja pse lëvizi në 5,3%. Tani e kemi 5,1%, është 88,8 miliardë, që është e konsiderueshme, dhe do të vazhdojë nominalisht të rritet. Praktikisht objektivi ynë është ta mbajmë në nivelin 5%, pavarësisht parashikimeve të sotme afatmesme.

Ju e keni praktikën, së bashku me mua, që në vazhdimësi ne i përmirësojmë parashikimet afatmesme, duke iu referuar edhe arritjeve vjetore ose, po të doni, defekteve vjetore, ose risqeve vjetore, por objektivi është që ta mbajmë në nivelin 5% të prodhimit të brendshëm bruto.

Në të njëjtën kohë për sa i përket infrastrukturës, së cilës iu referuat me rënie, praktikisht ka një spostim në nivelin e shpenzimeve operative për shkak të natyrës së shpenzimeve, por ajo që unë dua të theksoj është që tek infrastruktura kemi strukturuar logjikën e moshapjes së projekteve të reja, si stili i dikurshëm, që me 1 milion lekë hapeshin projekte me 1 miliard lekë, por të jemi të strukturuar që të vazhdojmë të financojmë ato projekte, të cilat mbyllen brenda këtij mandati.

Ndërkohë, mos harroni që kemi planifikuar edhe financimin me pagesat vjetore të rrugëve nacionale, që bëhen me projektet e rëndësishme të partneritetit publik-privat, si, për shembull, Rruga e Arbrit, që e fillon pagesën e kushtëzuar me kohë dhe volum punimesh, ku në bazë të informacionit që kemi nga Ministria e Infrastrukturës, viti 2019 do të ketë kërkesë financimi dhe ne e kemi planifikuar, si dhe fillojnë projektet e tjera 2020-2021. Pra, po ecim kujdesshëm, sepse na takon ne, juve dhe mua, t'i mbajmë amortizatorët e ekonomisë dhe të

financave publike në një masë të tillë, që në çdo rast të një goditjeje, praktikisht, ne të jemi të përgatitur. Përgatitja fillon në kohë të mirë dhe kjo është kohë relativisht e mirë, ku ne jemi duke rritur të ardhurat dhe ku po mbajmë nën kontroll shpenzimet.

Sigurisht, reflektimi i këtij drafti do të duhet të konsiderohet edhe në bazë të të pritshmit të vitit 2018. Ne kemi Fondin Monetar Ndërkombëtar këtë javë në ministri dhe jemi duke diskutuar edhe parametrat kryesorë të buxhetit, sigurisht këto i diskutojmë në bazë të të pritshmit, por do ta ndajmë edhe me ju atë tabelë menjëherë sa ta kemi.

Për sa u përket gjithmonë të brendshmeve, rreth 52 miliardë janë projektet në vazhdim dhe rreth 3 miliardë janë alokim të projekteve të reja, pra kosto vjetore e vitit 2019. Javën e kaluar hapëm 2,2 miliardë projekte të reja me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, me një rialokim të rëndësishëm, por sigurisht që ato janë pjesë e planifikimit për projektet e reja për vitin 2019 e më tej.

Nuk e di nëse lashë ndonjë pjesë të pyetjeve tuaja. Nëse po, ma rikujtoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Ministër!

Vazhdojmë mbledhjen me pyetje të tjera dhe pastaj me diskutime.

Kush e do fjalën?

Po, zoti Xhakolli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni pyetje, apo diskutim?

Ilir Xhakolli – Kam pyetje.

Zoti Ministër, meqenëse qeveria ka kohë që është në bisedime me minatorët për statusin e tyre, por, edhe në dijeninë time, është një vlerë e konsiderueshme edhe për buxhetin e shtetit, në qoftë se ajo do të arrijë në akord, keni parashikuar gjë në këtë projektbuxhet?

Anastas Angjeli – Po, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Po, janë parashikuar brenda fondit të pensioneve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti drejtues i mbledhjes!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin e shpenzimeve lidhur me projektbuxhetin e vitit 2019, ku në këtë buxhet mbështetet konsolidimi i mëtejshëm i reformave të ndërmarra nga ana e qeverisë, të cilat promovojnë rritjen ekonomike,

punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe procesin e integritetit në Bashkimin Europian!

Unë kam dy pyetje.

Më 2 shkurt të vitit 2017 ne kemi miratuar në parlament ligjin nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”. Pyetja e parë është: a i keni parashikuar në buxhet fondet për fillimin e zbatimit të këtij ligji, pasi deri tani janë lëshuar më shumë se 1500 dëshmi për përfitimin e statusit të naftëtarëve? Kur mendoni se do të fillojë zbatimi i këtij ligji?

Pyetja e dytë ka të bëjë me faktin që si ju, ashtu edhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, keni qenë të angazhuar në kryerjen e pagesës së dëmshpërblimeve të 71 familjeve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tronditjet e tokës në njësinë administrative Zharrëz, zonë e së cilës jam deputete. Dihet që janë vlerësuar edhe shtëpi, të cilat janë dëmtuar pjesërisht dhe vlera e këtij vlerësimi nga ana e komisioneve në terren ka kapur shifrën 54 milionë, kurse numri i shtëpive është gati 531? A i keni parashikuar këto shpenzime në buxhetin e vitit 2019, pasi dihet që kjo është zonë problematike, është zonë industriale, ku kompanitë “Bankers” dhe “Albpetrol” ushtrojnë punën në këtë territor?

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Po, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Për sa i përket pyetjes për statusin e naftëtarit, ka një përpjekje për ta rakorduar statusin në lidhje me mundësitë dhe racionalitetin, duke i vendosur naftëtarët dhe minatorët në të njëjtin standard reflektimi. Madje, brenda asaj që thashë, që iu përgjigja edhe zotit Xhakolli, brenda fondit të pensioneve është parashikuar edhe kjo pjesë.

Për sa i përket dëmshpërblimit për zonën e Zharrëzës, është përgjegjësi e kompanisë “Bankers”, që e ka dëmtuar, madje në vendimin e qeverisë ne kemi bërë përgjegjës kompaninë për t’i dëmshpërblyer ata banorë.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Ministër!

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Zoti Ministër, ne e respektojmë dhe mendoj se është një mesazh i rëndësishëm politik, si Komisioni Financash, faktin që nuk hyjmë më në aritminë elektorale, ku çdo dy vjet kemi pasur një traditë të dëmshme për financat publike dhe për stabilitetin makroekonomik, ku kishte buxhete elektorale. Megjithatë, nga ana tjetër, duke ditur edhe përgjegjësitë e mëdha, por edhe fondet që ju kemi lënë në dispozicion, cili është mendimi i qeverisë dhe si

mund të stimulohet që, patjetër, edhe këta që janë në bashki dhe do të jetë vit elektorale, të kenë më shumë akses, të punojnë më shumë, si dhe të japin edhe më shumë për elektoratin, meqenëse do të jetë edhe vit elektorale? Cilët janë mekanizmat e tjerë? Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë, në bujqësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, ne e respektojmë këtë pjesë dhe e shohim që është shumë e balancuar, pra nuk ka më fonde që çohen, dhe kjo është gjë shumë e mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja është: këto bashki, që të gjitha njëherazi janë përgjegjëse, si mund të stimulohen apo çfarë mekanizmash ka qeveria që të punojnë edhe më shumë këtë vit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, edhe të vihen para përgjegjësisë.

E dyta, në raport me bujqësinë, ju thatë që do të kemi një mekanizëm, i cili ka filluar të funksionojë dhe do të jetë gjithnjë e më shumë në zgjerim, do të jetë ena e komunikimit me fondet e Bashkimit Europian.

Pavarësisht se ne do ta kemi edhe ministrin e Bujqësisë këtu, dua të di: sa është aftësia përthithëse e këtyre fondeve deri sot dhe si do të shkojë, në terma afatmesëm apo edhe afatshkurtër, apo edhe si mund të përmirësohen këto aftësi përthithëse? Sepse deri sot kanë qenë të ulëta, që ne të arrijmë potencialin kryesor të asaj që thamë, që, në radhë të parë, të jenë më efikasë dhe të kenë një sens më të matur ekonomik, pra të mos jenë para që vijnë patjetër nga ekonomia shqiptare dhe shpeshherë kanë qenë të përdorura politikisht, domethënë nuk kanë pasur vlerën e shtuar që sillnin në ekonomi? Pra, si do të arrijmë ne që edhe ta ndihmojmë qoftë ministrinë e linjës, duke bashkëpunuar me këto kooperativa, për të cilat ne ndryshuam edhe ligjin në radhë të parë, qoftë edhe fermerët, për të rritur efikasitetin dhe aftësinë përthithëse të këtyre fondeve, që do të jenë gjithnjë e më shumë vitale në zhvillimin e bujqësisë shqiptare? Këto pyetja kisha.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Bushati!

Po, zoti Ministër, cila është përgjigjja juaj?

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Bushati!

Ne e kemi kthyer tashmë në traditë të rëndësishme njëtrajtshmërinë në financat publike, pavarësisht nga viti elektorale, qoftë parlamentar, qoftë lokal.

Viti 2017 tregoi se sa të konsoliduar ishim në këtë logjikë. Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” është pjesë e rëndësishme e ligjit organik të

buxhetit, por çdo ligj do edhe angazhimin politik, sidomos këto lloj ligjesh, të cilat mund të interpretohen në mënyra të ndryshme nga forcat politike. Në vitin 2017 u konsoliduam, ulëm borxhin publik; të njëjtën gjë po bëjmë për vitin tjetër, por mënyra më e mirë për të promovuar punën e pushtetit vendor është rritja e transfertës, standardizimi dhe transparenca, në funksion të investimeve dhe shërbimeve; brenda shpenzimeve, raporti i investimeve në funksion të aseteve të reja dhe shërbimeve, si dhe personeli, mirëmbajtja dhe operacionet. Këto raporte janë shumë të rëndësishme dhe, po ta shikoni, buxheti i vitit 2019 për pushtetin vendor rritet konsiderueshëm (11%, me 5 miliardë lekë), që i jep mundësi pushtetit vendor të financojë reformat e tij brenda komuniteteve. Tjetra ka një raport shumë të rëndësishëm me furnizimin me fonde nga ana e qeverisë qendrore, pra që është transferta e përgjithshme e pakushtëzuar, dhe me instrumentet në dorë të pushtetit vendor.

Taksa e ndërtesave është një instrument tejet i rëndësishëm në duart e pushtetit vendor për të rritur të ardhurat; është një taksë ende e paeksploruar, do të duhet ta pranojmë. Pra, taksa e pronës, taksa e ndërtesave ka një hapësirë shumë të madhe për të rritur të ardhurat e pushtetit vendor për t'i dhënë të drejtën, për t'i dhënë mundësi këtij të fundit që të bëjë atë që duhet të bëjë ndaj komuniteteve. Kështu që unë besoj se brenda kuadrit të financave publike pushteti vendor është financuar në mënyrë të rëndësishme.

Mos harroni se nëpërmjet ligjit të financave vendore kemi zgjeruar me ta ndarjen e të ardhurave. Pra, ndarja e të ardhurave qendrore praktikisht është ndarë në mënyrë të konsiderueshme me pushtetin vendor, përtej transfertës prej 1%. Kjo i bën njësitë vendore të luftojnë anti-informalitetin në territoret e tyre për më shumë transparencë dhe për një raport më të shëndetshëm ndërmjet investimeve dhe financimeve të shërbimeve me pjesën tjetër. Sigurisht që ligji i financave vendore është një disiplinim i rëndësishëm, që praktikisht ishte relativisht i pamundur më parë për shkak të kuadrit ligjor, ndërkohë që tani kuadri ligjor është shumë i qartë.

Ato disiplinime që i kemi vendosur vetes ne, si pushtet qendror, nëpërmjet ligjit të financave vendore ia vendosim edhe pushtetit vendor, në funksion të borxhit të qeverisë së përgjithshme.

Jam i bindur se ju e kuptoni shumë qartë se çfarë jam duke referuar. Në finale, borxhi i qeverisë qendrore dhe i asaj lokale, që është borxh i qeverisë së përgjithshme, rëndon njëlloj mbi qytetarin dhe sipërmarrjen.

Në këtë aspekt, disiplinimi është shumë i rëndësishëm, por edhe në funksion të asaj që ju thatë.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Ministër!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zonja Gjylameti.

(Deputeti Bushati flet pa mikrofon.)

Po, urdhëroni!

Arben Ahmetaj – Ndjesë, zoti Bushati!

Unë e theksova që viti 2019 është vit shumë i rëndësishëm për bujqësinë, është një vit që e mirëfinancon bujqësinë. Unë e bëra edhe një raport pak më parë për ju se sa investime kemi mundësi të hedhim në bujqësi vetëm nëpërmjet dy programeve. Do të duhet të përmirësojmë kapacitetet thithëse. Unë mendoj se është shumë e rëndësishme që Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR-ja) të përmirësojë administrimin e aplikimeve, madje jemi të gatshëm ta mbështesim me financim dhe me numra punonjësish.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Ministër!

Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Atëherë, zoti Ministër, duke vlerësuar maksimalisht mënyrën e hartimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2019, duke marrë parasysh faktin e një kuadri makroekonomik dhe një konsolidimi të mëtejshëm fiskal, kam një pyetje në lidhje me pjesën e shpenzimeve në Ministrinë e Bujqësisë, të fokusuara kryesisht në shtimin e tokës, flas për kanalet ujitëse, vaditëse dhe kulluese: cilat janë objektivat që janë parashikuar të arrihen, duke marrë parasysh edhe ato për pjesën afatmesme? Vërej se në zërat kryesorë Ministria e Bujqësisë ka një rritje të shpenzimeve me 0,4 miliardë lekë, por ndërkohë si synim kryesor, lidhur edhe me mbështetjen e bujqësisë, që është në kuadër të të gjitha politikave apo lehtësirave nga paketa fiskale, dua të di ekzaktësisht: a do të arrijmë t'i realizojmë këto objektiva që kemi për të shtuar, ku, nga njëra anë, të krijojmë infrastrukturën e nevojshme që bujqit të zhvillojnë aktivitetin e tyre; nga ana tjetër, paketat fiskale. Por a do të jetë e mundur kjo me këtë total shpenzimesh që kemi parashikuar për Ministrinë e Bujqësisë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe uljes së totalit të shpenzimeve për këtë ministri. E dëgjova përgjigjen tuaj ndaj zonjës Kushi, në lidhje me faktin se duam të financojmë ato projekte për të cilat ka mundësi dhe fizibilitet. Nga ana tjetër, në zërat që shikoj këtu mungon një nga akset kryesore të ndërlidhjes, siç është ai i Tiranës me Durrësin (me rrugën e dikurshme), flas për aksin Vaqarr – Ndroq dhe në vazhdimësi.

Ka qenë shumë herë në prioritetet tona dhe ndërkohë i shërben jo vetëm zonës, pra jo vetëm lëvizshmërisë së atyre që jetojnë, por edhe lidhjes me pjesën e Durrësit, një zone që ka potencial tejet të madh bujqësor dhe turistik. Këtu përsëri e lidh me atë që janë politikat tona nxitëse të agroturizmit apo të zonave, apo 100 fshatrave. A është menduar, sepse te zërat buxhetorë nuk e shoh? Ndërkohë, cila do të jetë zgjidhja?

Pyetja e tretë lidhet me transfertat e pakushtëzuara, ku një nga kriteret bazë është numri i popullsisë, ndërkohë që kemi shumë bashki, të cilat në sezone turistike dyfishojnë, trefishojnë apo edhe katërfishojnë numrin e tyre vetëm për atë periudhë. A e keni menduar nëse do të ketë një mundësi korrigjimi të formulës për të arritur t'i mbështesim këto bashki për atë kohë dhe jo për të gjithën, sepse nuk e parashikojmë dot numrin, por të paktën për periudhën e sezonit turistik?

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Po, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Për sa i përket bujqësisë, unë mendoj dhe besoj, madje e kam thënë disa herë në komision që është sektori më i mirëfinancuar në vitin 2019, me të gjitha objektivat, dhe këto të fundit janë të furnizuara me financime.

Do të doja të sillja në vëmendjen tuaj që janë katër shtylla kryesore, tre nga të cilat janë mbështetja e drejtpërdrejtë e qeverisë, pra të financimit të bujqësisë.

Së pari, është mbështetja për fermerët, që është 2,6 miliardë, me një rritje gati 1 miliard, në krahasim me vitin 2017. Pra, te bujqësia ne kemi lëvizur në mënyrë të konsiderueshme edhe hapësirat fiskale të sektorit, por sipër, pra për t'i zgjeruar.

Së dyti, është IPARD-i, ku, për hir të së vërtetës, korsa e buxhetit të shtetit është furnizuar me 1 miliard lekë, që do të thotë se ministria përgjegjëse për bujqësinë ka mundësi të hedhë në terrenin ekonomik bujqësor rreth 40 milionë dollarë, pra 4 miliardë lekë investime të drejtpërdrejta në formë granti apo të mbështetjes.

Në të njëjtën kohë kemi edhe skemën e garancisë, të ndërtuar me BERZH-in, të cilën mos harroni që e financojmë vitin që vjen me gati 18 milionë dollarë, pra 1.8 miliardë lekë, që është një financim i konsiderueshëm dhe raporti aty është 1 me 5. Ministria përgjegjëse për Bujqësinë ka mundësi të nxis bankat në dhënien e kredive, sepse ne e kemi financuar për kredi me subvencion kolaterali, pra garancia nga qeveria përdoret si mbështetje kolateralizimi dhe subvencioni i interesave. Pra, do shumë vëmendje nga Ministria përgjegjëse për Bujqësinë.

Në korsinë e katërt janë bankat dhe mikrokreditë. Në këndvështrimin tim, nëse do të më pyesni më në detaje se çfarë duhet të bëhet me bujqësinë përtej asaj që po bëjmë sot, besoj se ministri i Bujqësisë është shumë i qartë për këtë edhe për shkak të ndryshimeve fiskale që ne kemi bërë, është promovimi i ekonomisë së shkallës dhe modernizimi i bujqësisë. Sado para t'i hedhim bujqësisë, nëse terreni ekonomik do të ngelet i fragmentuar, nuk do të ketë produktivitet. Pra, mund të hedhim pafund para në një bujqësi të fragmentuar dhe jo moderne dhe nuk do të marrim mbrapsht atë që dëshirojmë.

Shpresoj t'i jem përgjigjur pyetjes suaj direkt dhe indirekt, por besoj që duhet bërë një punë e madhe. Fatmirësisht ministri dhe Ministria e Bujqësisë janë shumë të qartë në promovimin e ekonomisë së shkallës dhe modernizimit të bujqësisë, ndryshe, sado para të hedhim, nuk do të ketë produktivitet mbrapsht.

Për sa i përket pyetjes për infrastrukturën, ka nisur një proces partneriteti publik – privat për rrugën Tiranë – Durrës, për zgjerimin me 3 korsi të aksit kryesor, i cili në statistikë dhe në monitorim shikohet i tejngopur nga trafiku, prandaj ka ardhur koha për zgjerimin me tri korsi. Ky propozim është i shoqëruar edhe me përmirësimin e rrugës dytësore dhe rikonstruksionin e segmentit që iu referuat Tiranë – Ndroq – Plepa. Kjo është arsyeja përse nuk ka një kategori buxhetore, sepse do të trajtohet nëpërmjet partneritetit publik – privat. Dua ta them këtu në komision dhe publikisht që nuk do të ketë mbështetje nga buxheti, pra nuk do të ketë kosto buxhetore, por do të jetë e gjitha e bazuar tek *toll*-i.

Cila ishte pyetja e tretë?

Blerina Gjylameti – ... e pakushtëzuar dhe një lloj korrigjimi të formulës, për shembull për të gjitha bashkitë që kanë sezone turistike.

Arben Ahmetaj – Ju e dini njëlloj si unë që formula është në ligj dhe që të modifikojmë alokimin e fondeve do të duhet që të përpunojmë formulën.

Personalisht më duket racionale ajo që thoni, sepse ka bashki që kanë një numër shumë të madh turistësh gjatë verës, por në të njëjtën kohë mendoj që ata përfitojnë shumë më shumë nga të ardhurat, nga turizmi, nga zhvillimi ekonomik dhe nga taksa e infrastrukturës, sepse aty ka më shumë shërbime. Nëse doni mund të krahasoni Pukën me Himarën, Devollin me Divjakën, Gjirokastrën me Vlorën, Elbasanin me Tiranën dhe Malësinë e Madhe me Shkodrën dhe me Velipojën. Pra, nëse i marrim të gjitha racionalitetet ekonomike, ato bashki që ju iu referuat mund të kenë nevojë për mbështetje, por në të njëjtën kohë kanë avantazhe ekonomike. Pra, atë që ju e merrni si problematikë, që me të drejtë rritet numri i popullsisë për shkak të turizmit, nga ana tjetër ka një peshore, pra ka avantazhe ekonomike për shkak të ndërtimit, taksës së infrastrukturës, për shkak të të ardhurave dhe të

konsumit. Nëse i shikoni të dhënat e fundit të rritjes ekonomike, e cila është e pabarabartë në të gjithë Shqipërinë, ka bashki që e kanë rritjen ekonomike dhe punësimin shumë më të madhe se pjesa tjetër.

Gjithmonë ka nevojë për fonde, por besoj se ka nevojë për një menaxhim më rigoroz. Ky është mendimi im, por gjithsesi formula ndryshohet me ligj. Mund të ftojme USAID-in, sepse ai na ka ndihmuar për formulën, ta ripunojmë me atë që ju saktësisht thoni dhe vitin tjetër të kemi mundësi ta akomodojmë në logjikën që ju iu referuat.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti ministër!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Meqenëse nuk ka dhe ne po shkojmë drejt fundit të diskutimit të pjesës së shpenzimeve, më lejoni të them që ky diskutim dëshmoi edhe një herë për politikën e kujdesshme fiskale që po ndiqet, sidomos për shpenzimet, e cila synon njëkohësisht vazhdimin e ruajtjes së konsolidimit fiskal, por edhe të mbështetjes së politikave të zhvillimit dhe të prioritetëve, duke i orientuar fondet në ato drejtime kryesore që qeveria ka përcaktuar në programin e saj. Besoj që mbështetja është për një politikë të kujdesshme të llojit që po prezantohet, pavarësisht nga korrigjimi i rritjes së shpenzimeve, pasi duhet të mbajmë ekuilibrat buxhetore jo vetëm për këtë vit, por edhe për vitet e ardhshme.

Gjatë diskutimeve që po zhvillohen në komisione, por edhe në Komisionin e Ekonomisë për shpenzimet dhe të ardhurat, deri tani kanë dalë disa problematika, prandaj i bëj thirrje ministrit dhe stafit të tij që të ndjekin me kujdes diskutimet që po zhvillohen në komisionet e tjera gjatë tri ditëve të fundit të javës, me qëllim marrjen e masave për reflektimin e tyre dhe në përputhje me agjendën të paraqesim ato amendamente që duhen, nëse do të arrijmë të bëjmë disa ndryshime për buxhetin, sidomos nga diskutimet që bëhen në komisionet e tjera.

Po u kthehem dy-tri çështjeve që u diskutuan këtu dhe po filloj me pyetjen e zonjës Gjylameti për çështjen e pushtetit vendor. Pa dyshim që është e lidhur me një realitet ekonomik, i cili vitet e fundit ka ndryshuar për zonat turistike dhe janë mbi 2 milionë e 300 mijë turistë, të cilët vizitojnë në mënyrë periodike për të paktën 4-5 muaj vendin tonë dhe pa dyshim që një realitet i ri kërkon një reflektim të ri. Formulatat dhe treguesit nuk janë të dhënë një herë e përgjithmonë dhe për sa kohë që kemi faktorë të rinj të shfaqur në territor ato mund të konsiderohen. Gjithashtu edhe ministri tha që është i gatshëm të bëjë ndryshimet së bashku me asistencën që duhet. Natyrisht që ndryshimet bëhen me ligj dhe ne këtu jemi për të ndryshuar dhe përmirësuar ligjet, prandaj në momentin e duhur duhet të jemi të përgatitur.

Pastaj, a do të duhet të përballemi me ndonjë ndryshim tjetër në këtë projekt që kemi për të plotësuar ndonjë nevojë? Kjo është një çështje që duhet ta diskutojmë.

Çështja e dytë është çështja e bujqësisë. Unë besoj se stafi i Ministrisë së Financave duhet të jetë në kontakt edhe me dy komisionet e tjera për të zgjidhur problemet që ministri përmendi, në mbështetje të fondit për AZHBR-në, ndryshe mund të marrë alokime brendapërbrenda, për të cilën besoj se nuk krijon ndonjë shqetësim, prandaj duhet të jeni të përgatitur edhe për këtë çështje.

Një çështje tjetër, këtu u fol për kujdesin e madh që ne po i kushtojmë, përsëri me këto mundësi që janë, një pakete solidare të Ministrisë së Shëndetësisë. Nga informacioni që kemi deri tani, në disa komisione ka dalë problemi i mbështetjes së disa bashkive, të cilat janë në qendër dhe janë larg me çështjen e emergjencave. Unë nuk besoj se kjo përbën ndonjë problem, prandaj duhet ta shikoni edhe këtë çështje me komisionet e tjera, sepse këto tri ditë do të diskutohet deficitin dhe borxhi dhe të paktën gjatë diskutimit në parim duhet të diskutohen. Kjo është një çështje që duhet konsideruar me qëllim që të kemi një mundësi më të mirë për të mbështetur nevojat e qytetarëve me çështjet e emergjencave të shëndetësisë.

Kemi edhe dy çështje të rëndësishme që dolën gjatë diskutimit. Çështja e parë janë projektet me partneritet publik privat, që do të diskutohen në komision në mënyrë të hollësishme ditën e martë, pra do t'u kushtohet një seancë e veçantë, prandaj do t'ju lutesha që deri në fund të javës të risillni një tabelë me informacion të saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në relacion, por në të njëjtën kohë duhet të jetë me efekte pozitive që sjell në ekonomi, me risqet e parashikuara dhe përballjen e tyre, kjo me qëllim që ditën e martë, kur të zhvillohet ky takim, të jemi të përgatitur.

Këtu u ngrit problemi që ka të bëjë me projektet në vazhdim dhe përfshirjen e tyre në buxhet, ku 15 miliardë lekë janë projekte që janë në vazhdim dhe 3 miliardë lekë janë për hapjen e projekteve të reja. Pra, siç duket ka ndryshuar sjellja jonë, nga sjellja e mëparshme për hapjen e të gjithë projekteve me shuma të vogla, tani projektet do t'i çojmë deri në fund, në mënyrë që të jenë më efektive. Për këtë do t'ju lutesha që deri në fund të javës të kemi një informacion të saktë se cilat do të jenë projektet që do të vazhdojnë nga ky vit në vitin tjetër dhe cilat janë projektet e reja që parashikohen të hapen. Kjo për informim.

Në fund u ngrit edhe një shqetësim për statusin e naftëtarëve, ne nuk kemi vetëm një status, por janë disa dhe besoj se edhe ministri, kur dha shpjegimin, ka parasysh që janë disa statute që përfshihen brenda fondit të pensioneve, si statusi i naftëtarit, si i minatorit dhe ai i metalurgut.

Së fundi është një projektligj që ka ardhur në Kuvendin e Shqipërisë dhe ka të bëjë me statusin e veteranëve dhe dëshmorëve të luftës, prandaj pyetjet që keni mund t'i drejtoni në seancat në vazhdim, për të marrë saktësisht shumat e përfshira në fondin e pensioneve apo në zërat e tjerë që përballen me këto statuse.

Nesër mbledhja do të vazhdojë në orë 9:30 me çështje që kanë të bëjnë me deficitin buxhetor dhe borxhin publik, prandaj jeni të lutur që të jeni të gjithë këtu.

Seanca mbyllet me Ministrinë e Financave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Reme Lala, dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Vilma Causholli – Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Delina Ibrahimaj – Drejtoreshë e përgjithshme në INSTAT

Maldi Dema – Koordinator për cilësinë statistikore në INSTAT

Anastas Angjeli – Vazhdojmë me çështjen e dytë që ka të bëjë me projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar””.

Fjalën e ka drejtoresha e përgjithshme e Institutit të Statistikave.

Delina Ibrahimaj – Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar”” i propozohet për miratim Kuvendit të Shqipërisë në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, sipas të cilit INSTAT pozicionohet në nivelin e institucioneve të pavarura, të cilat i raportojnë drejtpërdrejtë Kuvendit. Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, i cili propozohet të ndryshohet rregullon strukturat e kësaj kategorie institucionesh për nivelin e pagës së titullarit të institucionit. Pas miratimit të ligjit për statistikatat zyrtare, drejtori i përgjithshëm nuk është më pjesë e piramidës së personave që gëzojnë statusin e nëpunësit civil pasi ai emërohet nga Kuvendi sipas një procedure tjetër, ndërkohë që gëzon një mandat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Projektligji propozon shtesën në pikën një të nenit 2 të Institutit të Statistikave, duke u bërë pjesë e grupit të institucioneve të pavarura, si dhe shtesën e pikës 12 në klasifikim “d” të lidhjes nr. 1, duke propozuar që raporti i pagës së drejtorit të përgjithshëm të jetë 0,6 ndaj pagës së Presidentit të Republikës.

Miratimi i këtij projektligji do të mundësonte përmbushjen në mënyrë të plotë të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë, për pozicionimin e INSTAT në një hierarki më të lartë të administratës publike.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, drejtuesi i seancës!

Kuvendi i Shqipërisë në prill të vitit 2018 miratoi ligjin nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, sipas të cilit INSTAT-i shpreson juridik publike të pavarur.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT emërohet nga Kuvendi me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe struktura organizative e INSTAT-it miratohet me vendim të Kuvendit në përputhje me legjislacionin në fuqi për institucionet e pavarura. Këto ndryshime ligjore kanë diktuar edhe nevojën për bërjen e disa ndryshimeve në ligjin nr. 9584 datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të

institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”, me qëllim përfshirjen e INSTAT-it në grupin e institucioneve të pavarura, të trajtuara dhe të rregulluara nga ky ligj organik si dhe për përcaktimin, kategorizimin e pagës së Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave. Pra projektligji propozon shtesën në pikën 1të nenit 2 të përfshirjes së INSTAT në grupin e institucioneve të pavarura si dhe shton në listën e tabelës “d” të lidhjes 1 edhe trajtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT me pagë në raportin 0.6 kundrejt pagesës së Presidentit të Republikës. Paga e re e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT do të fillojë të aplikohet me datë 1 janar 2019. Kostoja shtesë financiare si pasojë e këtij kategorizimi të ri do të përballohet nga buxheti i parashikuar për INSTAT.

Përfundimisht është vlerësuar se këto ndryshime janë të nevojshme për mirëfunksionimin e këtij institucioni. Ftoj anëtarët e komisionit ta miratojnë projektligjin.

Gjithashtu shikoj që ka disa probleme të teknikës legislative, por që të mos hyjmë në detaje sektori juridik me sektorin tonë duhet t’i diskutojnë këto ndryshime, sepse është vetëm një rakordim, pra duhet bërë një riformatim.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

A ka pyetje?

Fjala për zonjën Dhima.

Antoneta Dhima – Meqenëse përfaqësuesja e Ministrisë së Financave është këtu, ky projektligj parashikon edhe kosto shtesë për buxhetin e shtetit, a i keni parashikuar këto ndryshime në buxhetin e vitit 2019?

Mimoza Dhëmbi – Për të reflektuar ndryshimin që po bëjmë tani, kostoja është e parashikuar në buxhetin e vitit 2019, por ndërkohë do të ketë edhe ndryshime të tjera në lidhje me strukturën, të cilat kanë kosto të vogla.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votim në parim të projektligjit. Kush është dakord me projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584 datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar””? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA